

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zelensky: SHBA po shtyn tre hapa për rinisjen e diplomacisë me Rusinë - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/zelensky-shba-po-shtyn-tre-hapa-per-rinisjen-e-diplomacise-me-rusine/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 20:02:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 19:57:04 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c9dd15aca13a8f2b4ce348f3b63fdb923c662eabaa3948bd741a6d497f5d11d3
TEKSTI	1335e10ab1adee73c396835b820092cb481adfe293637efd5b24c0317a86be87
PAMJA	8654d67224cc9e26bfa07b84af662056098e52a54f33ca16bac722153549fc19

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b5b3b5bbeba782a0811ea00420a34ff6d1671ef666f1c0634ef1e3f421158114
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b5b3b5bbeba782a0811ea00420a34ff6d1671ef666f1c0634ef1e3f421158114>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Edi Rama Donald Trump SHBA Gjyqi i UÇK KLGJ

BOTA

Zelensky: SHBA po shtyn tre hapa për rinisjen e diplomacisë me Rusinë

25 Shtator 2026 | 21:57

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka deklaruar se administrata e presidentit amerikan Donald Trump po shtyn përpara tre hapa konkretë që synojnë uljen e tensioneve dhe rikthimin e diplomacisë mes Ukrainës dhe Rusisë.

Sipas Zelenskyt, propozimet e mbështetura nga SHBA-ja përfshijnë një armëpushim të ndërsjellë ndaj sulmeve mbi infrastrukturën energjetike, rihapjen e korridorit të grurit në Detin e Zi dhe zhvillimin e një takimi trepalësh mes Shteteve të Bashkuara, Ukrainës dhe Rusisë.

Zelensky i bëri deklaratat në një intervistë për "Axios", pas takimit me Donald Trump në Nju Jork, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Sipas presidentit ukrainas, propozimi për ndalimin reciprok të sulmeve ndaj infrastrukturës energjetike ka ardhur nga pala amerikane dhe Kiev i është i gatshëm ta pranojë.

"Momentalisht në tryezë është një propozim: armëpushim ndaj infrastrukturës energjetike. Ne jemi gati", tha Zelensky.

Ai theksoi se një marrëveshje e tillë do të duhej të përfshinte ndalimin e sulmeve nga të dyja palët ndaj objekteve energjetike, në një përpjekje për të ulur tensionet dhe për të krijuar terren për hapa të mëtejshëm diplomatikë.

Hapi i dytë lidhet me rihapjen e korridorit të grurit në Detin e Zi, përmes të cilit Ukraina ka eksportuar produkte bujqësore. Zelensky tha se Ukraina e mbështet rikthimin e këtij korridori dhe se për këtë çështje janë zhvilluar kontakte edhe me Turqinë, Indinë, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Egjiptin.

Hapi i tretë është zhvillimi i një takimi trepalësh mes SHBA-së, Ukrainës dhe Rusisë. Sipas Zelenskyt, një prej vendeve që po shqyrtohet për zhvillimin e këtij takimi është Abu Dhabi, ndërsa Uashingtoni ka hedhur gjithashtu idenë që fillimisht të zhvillohen bisedime mes ekipeve teknike, përpara një takimi të nivelit të liderëve.

Zelensky tha se Ukraina është e gatshme të marrë pjesë në bisedime pavarësisht vendit apo formatit.

"Jemi të hapur për çdo vend, për çdo format", u shpreh presidenti ukrainas.

Ai shtoi se gjatë takimit me Trumpin kishte kërkuar që një takim trepalësh të zhvillohej me synimin që një armëpushim ndaj infrastrukturës energjetike të ishte ndër rezultatet e para

LAJMI I FUNDIT

21:54 Kili sekuestron mbi 200 fosile në një kontejner nga Madagaskari: Të zhdukura rreth 66 milionë vjet më parë

21:47 Putin: Gati për bisedime me Kievin pas zgjedhjeve, por Ukraina do të vuajë pasojat e sulmeve ndaj civilëve

21:42 Hitaj: Rama bëri gabim që nuk foli për Kosovën në OKB

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

21:37 "Rama bëri mirë që nuk foli për UÇK-në në OKB", Çollaku: Aty njihet sovraniteti serb mbi Kosovën

21:22 U tërhoq nga ekipi anglez, trajneri Tuchel: Cole Palmer po humbet shumë mundësi

21:21 Xi Jinping përfundon vizitën në SHBA

TESTIM

konkrete të tij. Zelensky tha gjithashtu se samiti i G20 në Miami në dhjetor mund të shërbejë si një tjetër mundësi për një takim të nivelit të lartë.

Megjithatë, ende nuk ka një marrëveshje përfundimtare mes palëve. Zelensky ka shprehur dyshime nëse presidenti rus Vladimir Putin është i gatshëm të angazhohet në një proces të tillë, ndërsa Kremli ka deklaruar se aktualisht nuk janë krijuar kushtet për rifillimin e bisedimeve të nivelit të lartë me Ukrainën.

Takimi mes Zelenskyt dhe Trumpit u zhvillua më 22 shtator në Nju Jork, në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ndërsa përpjekjet diplomatike amerikane për të rikthyer në tryezën e bisedimeve Ukrainën dhe Rusinë vijojnë në ditët e fundit.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Kili sekuestron mbi 200 fosile në një kontejner nga Madagaskari: Të zhdukura rreth 66 milionë vjet më parë

Zyrtarët doganorë në Kili zbuluan dhe sekuestruan më shumë se 200 fosile molusqesh të zhdukura. Ato u zbuluan në një kontejner transporti nga Madagaskari, i...

21:54 | 25/09/2026

BOTA

Putin: Gati për bisedime me Kievin pas zgjedhjeve, por Ukraina do të vuajë pasojat e sulmeve ndaj civilëve

Presidenti rus Vladimir Putin tha të premten se Moska ishte gati të rifillonte negociatat me Kievin pas zgjedhjeve parlamentare, por Ukraina u përpoq të sulmonte...

21:47 | 25/09/2026

BOTA | LAJM KRYESOR

Xi Jinping përfundon vizitën në SHBA

Presidenti kinez Xi Jinping ka përfunduar të premten vizitën e tij shtetërore në Shtetet e Bashkuara, e cila u shoqërua me një pritje të nivelit...

21:21 | 25/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontakttoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: